



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TIRANË**  
**AGJENCIA E MBROJTJES SË KONSUMATORIT**

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Trajtim i mbetjeve spitalore”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 22114311-5.

Vlera e Fondit Limit: 1,059,250 (një milion e pesëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

*1. Ofertuesi duhet të paraqesë:*

*a. Formulari i Ofertës, sipas Shtojces 1;*

*b. Lista e Çmimeve të Shërbimeve sipas Shtojces 2;*

*c. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

*ç. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5*

*d. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

**Argumentimi:** Kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021

*“Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojme Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, mepëryshim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashke me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prove paraprake në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.*

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

Referuar pikës 1 të shtojcës 7, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe shtojcës 8 të DST-së.

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për një periudhë maksimumi deri në 2 (dy) vitet e fundit financiare (2021,2022) një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së fondit limit lëshuar nga autoriteti përkatës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenin 41, neni 43 dhe neni 55 pika 4, të V.K.M Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, V.K.M Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar. “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: .... 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar ...”. Kjo procedurë është nën kufirin e ulët monetar dhe për këtë arsye, vlera e xhiros minimale të kërkuar, është brenda kufirit të parashikuar në dispozitat ligjore të sipërcituara.

**2.2.2** Vetëdeklarim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

*Kjo kerkese do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazes së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti*

*kontraktor do ti kërkojë ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve të deklaruar si më lart.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në nenin 77, pika 3, e LPP, nenin 43, pika 6, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe ligjin Nr.9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar.

Ky kriter shërben për të garantuar Autoritetin Kontraktor se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, kanë kapacitetet e duhura ekonomike dhe financiare si dhe janë të përshtatshëm për të kryer veprimtari profesionale. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2023 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

## **Aftësitë teknike dhe profesionale:**

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1** Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe/ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, neni 55, pika 4/b, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 20 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të disponojë të paktën 10 (dhjetë) punonjës të punësuar, të cilët duhet të figurojnë në listpagesen e fundit të shoqërisë të deklaruar nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me:

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për periudhën e fundit të deklaruar.
- Listpagesat e punonjesve të konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit që kerkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e fundit të deklaruar, shoqëruar me formularet e deklaramit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shendetesore.

*(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotesimin e formularit të vetedeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).*

**Argumentimi:** AK argumenton se kërkesa për punonjësit është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenit 41, pika 4, gërma “c”. Kërkesa specifike për stafin e kërkuar është përcaktuar që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Autoriteti Kontraktor vlerëson se ky është një numër minimal i kërkuar për të vërtetuar kapacitetin e fuqisë punëtore që duhet për të bërë të mundur realizimin në kohë dhe me sukses të kontrates.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë stafin e nevojshëm për realizimin e kontratës, në përbërje të të cilit të ketë minimalisht punonjës sipas profilit të mëposhtme, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e fundit të shoqërisë të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:

- (një) inxhinier Mjedisi ose (një) inxhinier Kimist

*(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotesimin e formularit të vetedeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).*

**Argumentimi:** AK argumenton se kërkesa për punonjësit është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenit 41, pika 4, gërma “c”. Kërkesa specifike për stafin e kërkuar është përcaktuar që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Ky lloji shërbimi

e ka te domosdoshëm një inxhinier sipas profilit te kerkuar. Autoriteti Kontraktor vlerëson se ky është një numër minimal i kërkuar për të vërtetuar kapacitetin e fuqisë punëtore që duhet për të bërë të mundur realizimin në kohë dhe me sukses të kontrates.

**2.3.4** Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë, ku merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit në varësi të kërkesave të Autoritetit Kontraktor, ku tërheqja e mbetjeve të rrezikshme spitalore do të bëhet duke respektuar standartin sipas VKM-së me nr. 798, datë 29.09.2010 “Për administrimin e mbetjeve spitalore”. Shtojca 4) “Kushtet që duhet të respektojë transportuesi i mbetjeve spitalore infektuese”.

**Argumentimi:** AK argumenton se kërkesa për punonjësit është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenit 41, pika 4, gërma “ç”. Kërkesa specifike është përcaktuar që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar si dhe mjetet e posaçme që nevojiten për realizimin me sukses të kontratës, pasi tërheqja e mbetjeve bëhet nga operatori ekonomik dhe duhet të jetë sipas standarteve të kërkuar sipas VKM-së me nr. 798, datë 29.09.2010 “Për administrimin e mbetjeve spitalore”. Shtojca 4) “Kushtet që duhet të respektojë transportuesi i mbetjeve spitalore infektuese”.

**2.3.5** Operatori ekonomik duhet të disponojë Liçence profesionale e leshuar nga QKB kategoria III.2B. për transportin e mbetjeve.

**Argumentimi:** AK argumenton se kërkesa është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenit 41, pika 4, gërma “a”, të ligjit Nr.10 463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar, si dhe te VKM-së me nr. 798, datë 29.09.2010 “Për administrimin e mbetjeve spitalore” Shtojca 4) “Kushtet që duhet të respektojë transportuesi i mbetjeve spitalore infektuese”, si dhe në mbështetje të VKM nr.402 date 30.06.2021 “Për miratimin e katalogut të mbetjeve” si dhe të ligjit Nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat, profesionale për realizimin objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

**2.3.6** Operatori ekonomik duhet të disponojë Leje mjedisore minimalisht Tipi B për sterilizimin e mbetjeve dhe Tipi A për incenerimin e mbetjeve duke përfshirë kodet 18 02 01, 18 02 02.

**Argumentimi:** AK argumenton se kërkesa është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenit 41, pika 4, gërma “a”, të ligjit Nr.10 463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar, si dhe te VKM-së me nr.

798, datë 29.09.2010 “Për administrimin e mbetjeve spitalore” Shtojca 4) “Kushtet që duhet të respektojë transportuesi i mbetjeve spitalore infektuese”, si dhe në mbështetje të VKM nr.402 datë 30.06.2021 “Për miratimin e katalogut të mbetjeve” si dhe të ligjit Nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat, profesionale për realizimin objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore. Autoriteti Kontraktor me anë të këtij kriteri siguron që trajtimi fundor i mbetjeve bëhet sipas kushteve dhe standarteve të kerkuara me aktet ligjore dhe nenligjore në fuqi.

**2.3.7** Operatori ekonomik duhet të paraqesë a) Dokumentacionin për vërtetimin e pronësisë (faturë blerje ose zhdoganimi) ose kontrate qeraje të pajisjes (autoklavës). b) Skedë Teknike të impiantit të autoklavës. c) Deklaratë Konformiteti CE të impiantit të autoklavës.

*(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotesimin e formularit të vetedeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).*

**Argumentimi:** AK argumenton se kërkesa është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 41, pika 4, gërma “a”, të ligjit Nr.10 463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar, si dhe të VKM-së nr. 798, datë 29.09.2010 “Për administrimin e mbetjeve spitalore” Shtojca 4) “Kushtet që duhet të respektojë transportuesi i mbetjeve spitalore infektuese”, si dhe në mbështetje të VKM nr.402 datë 30.06.2021 “Për miratimin e katalogut të mbetjeve” si dhe të ligjit Nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se posedojnë mjetet profesionale për realizimin objekt i kontratës. Autoriteti Kontraktor me anë të këtij kriteri siguron që trajtimi i mbetjeve bëhet sipas kushteve dhe standarteve të kerkuara me aktet ligjore dhe nenligjore në fuqi.

**2.3.8** Operatori ekonomik pas trajtimit të mbetjeve spitalore (sterilizimit me autoklavë), duhet të dorëzojë mbetjet e trajtuara në landfill dhe për këtë qëllim operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:

- Kontratë të lidhur drejtpërdrejt me një landfill të autorizuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për pranim të mbetjeve të trajtuara spitalore.

*(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotesimin e formularit të vetedeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).*

**Argumentimi:** AK argumenton se kërkesa është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021

“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenit 41, pika 4, gërma “a”, të ligjit Nr.10 463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar, si dhe të VKM-së me nr. 798, datë 29.09.2010 “Për administrimin e mbetjeve spitalore” Shtojca 4) “Kushtet që duhet të respektojë transportuesi i mbetjeve spitalore infektuese”, si dhe të mbeshtetje të VKM nr.402 date 30.06.2021 “Për miratimin e katalogut të mbetjeve” si dhe të ligjit Nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë realizimin fundorë të trajtimit të mbetjeve sipas kushteve dhe standarteve të kerkuara me aktet ligjore dhe nenligjore në fuqi.

**2.3.9** Operatori ekonomik duhet të disponojë minimum 2 (dy) mjete transporti të përshtatshëm për transport mallrash për llojin e realizimit të këtij shërbimi. Mjetet e transportit mund të jenë në pronësi ose me qira.

- a) Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) certifikate e kontrollit teknik (e vlefshme); d) siguracion mjeti (i vlefshëm);
- b) Për mjetet e deklaruara me qera duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse noteriale e qerasë b) dokumenti që verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi; ç) certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme) d) siguracion mjeti (i vlefshëm);

*(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetedeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).*

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 4, të nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” , të germa ç, pika 4 të nenit 41, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Nëpërmjet këtij kriteri kërkohet që Operatorët ekonomik të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund ti vihen në dispozicion 2 mjetet për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Mjetet e mësipërm janë të domosdoshëm pasi duke marrë në konsideratë llojin e shërbimit, natyrën si dhe kohëzgjatjen e saj i shërben Autoritetit Kontraktor për tu njohur me kapacitetet teknike të ofertuesve me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses. Duke qënë se kjo procedurë prokurimi ka në përbërjen e saj përveç shërbimit edhe transportimin dhe instalimin e pajisjeve tyre e bën të domosdoshëm kërkesën për disponimin nga ana e ofertuesve të mundshëm ekonomikë edhe të mjeteve të nevojshme për realizimin në kohën të shërbimit.

**2.3.10** Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatën ISO 45001:2018 (ose e përditësuar) lidhur me sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, e vlefshme dhe e lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e

Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes.

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me parashikimin e nenit 77, nenit 79, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 41 dhe nenit 44, të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se shërbimi objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e sigurisë në punë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

ISO 45001-2018 është standard ndërkombëtar, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i shërbimit objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e incidenteve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi. Çertifikata e kërkuara është në përpjestim me objektin e kontratës dhe respektojnë natyrën e saj.

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike. Specifikimet teknike, për shërbimin objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson shërbimin si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

**Argumentimi:** Specifikimet teknike të shërbimit objekt prokurimi janë hartuar në zbatim të kushteve dhe standarteve që nevojiten për trajtimin e mbetjeve sipas akteve ligjore dhe nenligjore të fushës përkatëse, konkretisht të ligjit Nr.10 463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar, të VKM-së me nr. 798, datë 29.09.2010 “Për administrimin e mbetjeve spitalore” si dhe në mbështetje të VKM nr.402 date 30.06.2021 “Për miratimin e katalogut të mbetjeve”. Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti. Sa më sipër, specifikimet teknike, janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për



miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Në specifikimet teknike përkufizohen karakteristikat e produkteve siç janë përshkrim i të gjitha kushteve që duhet të plotësojë produkti i prodhuar, forma dhe përmbajtja, llojet e materialit, përmasat etj në mënyrë që operatorët ekonomikë të interesuar, të kenë informacion të plotë dhe të kenë mundësi të përmbushin kushtet e kriteret sipas specifikimeve të hartuara nga AK.

Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimisht miratimin e dokumenteve të tenderit dhe si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave. Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurimin anëtar në NJP, për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt “Trajtim i mbetjeve spitalore”.